



Dukagjini

Botim Periodik i Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", Viti i XIV i botimit, nr. 149, mars 2016

Nr. Llog. UNIONBANK 510367047020112, Shkodër - Albania, Tel. 00355692465784, internet: www.shoqatadukagjini.com, Kryeredaktor: Luigj Shyti, Çmimi 30 lekë / 1.5 euro

Pashkët

Ringjallja e Krishtit

Urojmë besimtarët e krishterë

l'estamenti i poetit Frederik Rreshpja

**BASHKËBISEDIM ME SHKRIMTARIN PETRIT
PALUSHI, AUTORIN E LIBRIT "FREDERIK
RRESHPJA, QË S'E KUPTUAM KURRË"**

2

Frederik Rreshpja, jeta e këtij poeti të pazakontë, këtij tragjiku, nuk mund të shuhej pa një testament. Ai nuk kishte as prona as para për të lënë. Gjithçka kishte, ishte poezia dhe plaga e hekakaqes ku ai u përpëliti për gjithë jetën. Po. Kishte edhe një galeri emrash të atyre pak njerëzve që e vlerësuan dhe e ndihmuan, ndaj të cilëve u detyrohej një mirënjohje. Është kalvari i mundimeve dhe flaka e krijimit, më e shtrenjta dhe më e shenjta gjë që pati. Duhej një altar për t'ia besuar atë që dot nuk mund t'i merrte në varr me vete. Në atë varr ku prehet i qetë që prej 17 shkurtit të vitit 2006, tash 10 vite të shkuara.

Si erdhi 7 Marsi, në shkollën 9 vjeçare "Dedë Gjo' Luli", Hot i Ri

Eventet e ndryshme që kane institucionet shtetërore, siç janë festat, nuk kane qellim në vetvete vetëm për të festuar, por në radhe të pare për të bere bilancin e punës dhe marrjen e forcave të reja, për arritje më të mëdha për të ardhmen. Në këtë vështrim duhet shikuar edhe 7 Marsi për ç... olle e në veçanti për shkollën 9 vjeçare "Dede Gjon Luli", Hot i Ri, për të cilën shkruajmë.

4

MENDIME RRETH RRIEVE DHE TRADITAVE PËRBADHË KOHËS QË JETOJMË

6

Shehët që nuk pyesin për faktet

3

Nga Nikollë Loka

Kur lexon opinionet e Redi Shehut (opinione u thënshin), ndjen keqardhje dhe s'ka si mos të shkojë mendja në një kohë tjetër, 103 vjet më parë, në ditët e fundit të pushtimit osman, kur forcat ruse po merrnin Plovdivin dhe në anët tona po i afroreshin Durrësit, ndërsa në Shijak përflitej për fitore e turqve në Plovdiv. Sa për serbët, askush nuk e besonte se mund të hynin në Durrës. E dhimbshme, por dhe e justifikueshme, po të kemi parasysh çfarë kishte ndodhur me ne për pesëqind vjet ose 15 breza njëri pas tjetrit.

Po tani? Edhe në kushtet e këtij zhvillimi marramendës të teknologjisë së informacionit, ka një grup njerëzish që mendojnë se mund të mbahen me slogane dhe pa paraqitur asnjë fakt, ta detyrojnë njeriun e shekullit XXI t'u besojë qorrazi. Ajo kohë iku dhe nuk mund të kthehet. Sot flitet me fakte ose flitet kot; nuk ka rrugë të mesme. Njëri ndër ata që e mëshiron periudhën osmane të shqiptarëve është Redi Shehu që mendon se antikomunizmi mund të jetë një mënyrë për t'u bërë i pranueshëm edhe pa qenë bindës, sidomos për ata që mendojnë se komunizmi i ka ra në qafë periudhës së pushtimit turk.



'Testamenti i poetit Frederik Rreshpja

BASHKËBISEDIM ME SHKRIMTARIN PETRIT PALUSHI, AUTORIN E LIBRIT "FREDERIK RRESHPJA, QË S'E KUPTUAM KURRË"

Frederik Rreshpja, jeta e këtij poeti të pazakontë, këtij tragjiku, nuk mund të shuhej pa një testament. Ai nuk kishte as prona as para për të lënë. Gjithçka kishte, ishte poezia dhe plaga e hekakaqes ku ai u përpëlit për gjithë jetën. Po. Kishte edhe një galeri emrash të atyre pak njerëzve që e vlerësuan dhe e ndihmuan, ndaj të cilëve u detyrohej një mirënjohje. Është kalvari i mundimeve dhe flaka e krijimit, më e shtrenjta dhe më e shenjtja gjë që pati. Duhej një altar për t'ia besuar atë që dot nuk mund t'i merrte në varr me vete. Në atë varr ku prehet i qetë që prej 17 shkurtit të vitit 2006, tash 10 vite të shkuara. Ai mund ta linte testamentin e tij kudo kafeve të Tiranës, apo nëpër gjerbe ndesh me miq. Por ai, ndoshta më shumë se ai, fati, zgjodhi pikërisht Kukësin, i cili do të ishte jo vetëm si një ndalesë e udhëpërshkimit Prishtinë-Tiranë, por edhe një rrëfimtore. Zgjodhi, gjithashtu, një shërbestar të së hyshmes, tek i cili la dorëzanë gjithë ç'kishte. Ai ishte, zemërbardhi e zëngrohti, i palodhuri, shkrimtari dhe qëmtuesi Petrit Palushi, mikpritësi dhe caku i kungimit, pragu i amës dhe amaneteve. Epja para ikjes pa kthim. Dy ditë të atij nëntori të vitit 2005 do të ishin koha bisedore e gjithçkasë që kishte për të thënë dhe për të lënë këso jete si testament. Gjithçka që kishte për të dëshmuar ai ia la Petrit Palushit dhe asaj nevojë për të mos ikur tinëzish, pa i thënë çfarë ai kishte. Dhe Palushi e gdhendi këtë rrëfim në librin "Frederik Rreshpja, që s'e kuptuam kurrë". Një shpirti të dliër ai i kushtoi një qiell, një qiell ku shkrihet fati i Fredit njeri, i Fredit poet. Kishte dhe të tjera gjëra, të cilat mbetën jashtë këtij testamenti, të cilat Petrit Palushi kërkoi t'i ndajë me ne në këtë ndërmendje në 10-vjetorin e ndarjes nga jeta të Frederik Rreshpes, si një kujtesë që rreket të mbushë boshin që la kjo ikje.

– Gjatë bisedës së Frederik Rreshpes për Fredin, a kishte diçka që ju nuk e përfshitë qëllimisht në libër. Nëse po, duhet të kishit motivim bindës se pse duhet të mbetej jashtë kësaj rrëfimtoreje?

– Njeriu dhe poeti Rreshpja që i jashtëzakonshëm, sa real dhe surreal në bisedat e 11-12 nëntorit të 2005-s në Kukës. E ndjeja se, pa e kuptuar as ai vetë po linte Testamentin e vet. Një Testament që vinte frymëmarrje-frymëmarrje. Testament jetësor dhe letrar, mu aty ku Rreshpja mori goditjet: në jetë dhe letërsi. Ndoshta Testamenti më i çuditshëm në botë. Dhe unë e kapa kodin e atij Testamenti. Ai rrëfeu ferrin dhe përtej ferrin. Unë përcolla tek lexuesi vetëm pjesën që kish të bënte me ferrin e jetës së Rreshpes. Aty e ndala. Nuk doja që lexuesi të besonte se poeti imazhist shqiptar, poeti shqiptar më europiani padyshim, poeti i një ndjeshmërie të lartë, një Esenin tejet modern me lirikën e vet kishte shkruar ende pa vdekë edhe në përtej ferr, në përtej eksistencë. Bash për këtë, ajo pjesë rrëfimi që dramatike, tepër tronditëse. Kjo pjesë e përtej ferrit s'ka të bëjë me surrealen,

por realen e jetës së njeriut dhe poetit Rreshpja. Ai e preku ferrin, përtej ferrin (ajo që në Veri thuhet Me e kallëzue veç në Natën e Vorrit), por në gjallje të vet, që s'ndodh asnjëherë ose tepër rrallë, ai preku edhe Parajsën. Kjo ishte poezia e vet. Rreshpja tha: "Kam ditur të jetoj. Unë



di edhe të vdes. Të paktën, poezinë time e lashë për të tjerët. Do bindeni edhe për këtë gjë". Bohemi Rreshpja dhe mistiku njëkohësisht, u kujdes deri në imtësi, edhe për mbiemrin e vet të shkruhej si duhet, edhe të përmendte miqtë e afërt që i kishin ndejtur pranë. D.m.th., me një mirënjohje të njerëzishme të paskaj.

– Pyetja që nuk ia bëttë dot Fredit, për të cilën ju ka mbetur peng?

– Jo. Biseda rrodhi n'atë shtjellë sa m'u duk se ai rrëfeu shumëçka ose, më saktë, rrëfeu atë që duhej. Nuk kish shumë nevojë për pyetje n'atë bisedë natyrale, ku asgjë s'qe e tepërt, por dhe ku s'mungonte asgjë. Ai që plot dëshirë me rrëfye, me u shprazë krejt, me kallëzu për tragjiken e jetës së vet, për ato gjëra që e pa t'arsyeshme, ndërsa n'anën tjetër, unë kisha dëshirë me e dëgju pa kurrfarë mërzi, isha tepër i vëmendshëm n'ato që thoshte dhe me e regjistru që, herdokur ai rrëfim i butë dhe i vrazhdë të mos mbetej i msheltë vetëm në tavolinë dhe të bëhej publik. Nuk mund të veproja ndryshe. Do t'isha i pasinqertë me Rreshpen, por dhe jokorrekt me kulturën shqiptarë, së cilës do t'i humbte një prej dëshmime më tronditëse.

– Pse mendoni "Frederik Rreshpja, që s'e kuptuam kurrë"?

Kjo ka të bëjë me mosvëmendjen e shoqërisë shqiptare ndaj tij, me shpërfilljen, harresën e qëllimët. Sidomos të shoqërisë letrare. Për shkak të xhelozisë a të shumëçka tjetër. Atë s'e kuptuam në lirinë e tij, në përpjekjen me qenë i lirë në jetë dhe letërsi. Vdekja e tij që një vdekje e paralajmëruar, e përshpejtuar. Shoqëria jonë e nxitoi vdekjen e poetit me mosvëmendjen dhe indiferencën e saj të njohur, e pranojmë ose jo, ose nuk duam ta pranojmë. Dihej sëmundja dhe e pasmja e tij, por s'u kujtua kush që ai të kurohej. Letrarët e panumërt të Tiranës le të dilnin në protestë "Për shëndetin e Fredit", mu para Parlamentit. Ajo do t'i-

sh protesta më e veçantë në Europë. Pra, mungoi ndjeshmëria. Ai u shpërfill edhe në ditën kur po shkante në bujtinzën e fundme. Aty, vetëm miqtë e shokët. Përsëri, pra, përfaqësuesit e lartë të shtetit (të kulturës, natyrisht), larg dhe ftohtësisht e pandjeshmërisht ndaj asaj ceremonie të njeriut që s'qe vdekjetar i zakonshëm. Kanë kaluar 10 vjet prej vdekjes së tij dhe vepra e tij letrare e plotë ende s'është botuar. Do t'ish në nderin, por dhe detyrimin njëkohësisht të Ministrisë së Kulturës (jo vetëm të kësaj aktuale) të nxirrte fondin për botimin e kësaj vepre, të njerit prej poetëve më të shquar të këtij vendi, në mos më i shquari. Le të linte anash tre-katër botime të librave tullumbace! Kaq do mjaftonte. D.m.th., asnjëherë s'pati kohë të përshtatshme për të, por vetëm kohë anti-Rreshpe. Ai vdiq i pikëlluar në varfëri të plotë, edhe i sëmurë gjithashtu. Më thoshte: "Në Shqipëri, varfëria është vdekje". Veç kësaj, hipokrizia ndaj tij që e dukshme. E lavdëronin poezinë e tij nëpër tavolina, por s'e potencuan publikisht. Më tepër se cinizëm a keqdashje.

– Kishte diçka për të cilën folët me poetin ato dy ditë nëntori, diçka që ai e ndau me ju, por pa dëshirën ta dinte kush tjetër?

Natyrisht. Se n'atë bisedë u krijua një klimë e përshtatshme që ai të shprehej. Ka edhe gjëra të tjera tepër tronditëse që s'janë përfshi në libër. Në një rast na tha: "Këto gjëra po u them vetëm juve. Mbajeni për vete". E kish fjalën që unë dhe vëllai im, Fatmiri, i pranishëm në bisedë, të mos i nxirrim e t'i bënim publike. Kjo pjesë e pashplueme për lexuesin, më ka mbetë thëllësisht në tru. Asnjëherë s'kam qenë ndërdyshit t'i bëj publike, sepse biseda ka rregullat e veta, aq më tepër kur kërkohet që ato gjëra të ruheshin si të fshehta. Në tekstin e plotë që kam hedhë në kompjuter, pikërisht për pjesën ku Rreshpja kish thënë: "Mbajeni për vete", e kam ngjyrosë me ngjyrë të verdhë. Nuk besoj se më thyhet mendja në këtë pikë. Sepse, ka raste kur disa të fshehta duhet të ruhen. Ndërsa, pjesa ende e pashplueme që ka të bëjë me rrëfimin përtej ferrit, tash e ndiej se në ribotimin e librit duhet botuar.

– Gjatë bisedës me Rreshpen, në "In memoriam" ceket tek-tuk jeta e tij, por duke mos qenë ngulmëtare të bisedës. Folët si ju thye ai shpirt për të mos iu ngjitur kurrë. Dashuria e tij e parë tragjike, një djalë fryt i kësaj dashurie fatkeqe, të cilin e kërkoi kaq shumë dhe kurrë nuk e gjeti?

– Kjo gjë që thoni ju, u përmend disa herë në bisedë. Është në atë pjesën e pashplueme të bisedës, që rri ende grijas. Kam botuar shumë pak. Më thoshte: "Pa familje, pa nënën time, pa shoqni, pa gjithçka... Vetëm me poezi...". Nëse futemi te pjesa ende e pashplueme, tani për tani mund të përcjell shënimin: "Një djalë më iku. Ndoshta ma morën retë e zeza. Ah, sikur Zoti të më kish dhënë edhe një vajzë! Do i vija emrin më të bukur të

botës. Do e rrisja me dashuri si dashuria e Fredit, do e shihja në dritë të syve e ajo do kënaqej me mua. Por s'do të shkruaja poezi për të se e kisha para syve të mi. Se unë krijoj imazhet në poezi për gjërat që më mungojnë. E pyeta atë natë se ç'emër do t'i vinte vajzës. Jo, më tha. Se atë tani e kam vetëm si imazh. Imazhet nuk marrin emra. Ndërsa pakëz më vonë, u kthehej prapë aty. Po thoshte fjalë si shkujdesshëm. Kur mbaroi, bëra renditjen e tyre. Aty për aty kish krijuar një poezi të veshur me mjegull e dritë njëkohësisht, sikurse pak kohë më parë krijoj poezinë "Palca e vdekjes". Të nesërmen më përmendi emrin e vajzës. Atëherë, kisha në mendje emër tjetër, tha. Tani e ndryshova..."

– "Si s'u kënaqa një herë në jetë! Si nuk munda të përkëdhel fëmijë një herë! Pse Zoti pati nge të merrt vetëm me mua!" Kësisoj shtërzu shpirti i tij në Prishtinë pas takimit me studentin e panjohur. Mendoni se ai jetoj tragjikisht apo tragjike ishte jeta e tij?

– Rreshpja natyrisht që e donte jetën, anipse në çdo hap pati mure. Nuk donte ta jetonte atë tragjikisht, por fati i trishtë, rrethanat ia diktuan një gjë të tillë. Qe i dëshpëruar tek s'shkonte. Thoshte: "Tani Fredi është i vetëm... Tani as Zoti s'ia jep dorën...". Prandaj jeta e tij që tragjike. Edhe pse e tillë, ai gjeti një segment, një fije drite dhe u kap fort pas asaj që të hapte një shteg plot me dritë: poezinë e vet. Kjo ndodhte sepse "Asgjë s'qe e rastësisht në poezinë e tij" (Xh. Bajraj). Shijen e trishtë të jetës e kish hedhë papa krahëve, ndërsa tek poezia gjente qetësi, ngushëllohej, në një farë forme lazdrohej me të. Më thoshte: "Unë duhet t'ia jepja Nobelin poeteshës polake Shimborska, se ajo ka shkruar vargun: Këtu asgjë nuk ka ndryshuar. Kurse unë kam shkruar: "O ajër i mbrëmjes mbështillmë, erdhi ora të vdes përsëri".

– Studenti që e takoi në kafe, nxënësit që i dhanë lëshim duke kujtuar se ishte një lypës dhe inxhinierja që e përcolloi me makinë për në hotel, duket se ishin pengjet e tij dhe amaneti juaj. Prej atëherë e sot keni dijeni mbi identitetin e këtyre personazheve enigmatik që u ngulitën kaq fort në shpirtin e drobitur të lirikut?

– Qe e pamundshme t'i gjeja dhe t'i takoja, anipse Rreshpja e kishte fort merak. Donte të shlyente njëfarë borxhi ndaj tyre. Por që krejt e pamundshme. Megjithatë, ai sikur e zgjidhi vetë me fjalët e tij: "Kërkoi ata njerëz. Njerëzit e mirë kanë emra. Të këqijtë zhyten në mjegull e s'dallohen". Në mendjen e tij mbetën si imazh qytetarët e Prishtinës, por edhe vetë Prishtina si "Vend i poezisë së bukur". Sa herë shkoj në Prishtinë, më duket se i shoh ata njerëz që i ofruan ngrohtësi Rreshpes, por më shqiten prej syve të mi, se nuk mburren e nuk bërtasin kurrsesi se cilët ishin, si të thonë në heshtje se ata bënë vetëm detyrën. Ka të bëjë me magjinë e njerëzve të thjeshtë, etikën dhe modestinë e tyre. Mirësia zakonisht flet në heshtje, ►

Shehët që nuk pyesin për faktet

Nga **Nikollë Loka**

Kur lexon opinionet e Redi Shehut (opinione u thënshin), ndjen keqardhje dhe s'ka si mos të shkojë mendja në një kohë tjetër, 103 vjet më parë, në ditët e fundit të pushtimit osman, kur forcat ruse po merrnin Plovdivin dhe në anët tona po i afroreshin Durrësit, ndërsa në Shijak përflitej për fitore e turqve në Plovdiv. Sa për serbët, askush nuk e besonte se mund të hynin në Durrës. E dhimbshme, por dhe e justifikueshme, po të kemi parasysh çfarë kishte ndodhur me ne për pesëqind vjet ose 15 breza njëri pas tjetrit.

Po tani? Edhe në kushtet e këtij zhvillimi marramendës të teknologjisë së informacionit, ka një grup njerëzish që mendojnë se mund të mbahen me slogane dhe pa paraqitur asnjë fakt, ta detyrojnë njeriun e shekullit XXI t'u besojë qorrazi. Ajo kohë iku dhe nuk mund të kthehet. Sot flitet me fakte ose flitet kot; nuk ka rrugë të mesme. Njëri ndër ata që e mëshiron periudhën osmane të shqiptarëve është Redi Shehu që mendon se antikomunizmi mund të jetë një mënyrë për t'u bërë i pranueshëm edhe pa qenë bindës, sidomos për ata që mendojnë se komunizmi i ka ra në qafë periudhës së pushtimit turk.

Po antikomunistët çfarë thonë? Mehdi Frashëri në librin e tij "Problemet shqiptare" shkruan: "Një i huaj kur vjen nga Europa në Shqipëri, sheh një vend mjaft të bukur; me brigje deti, me limane të mira, me fusha pjellore, me ujëra të bulbërta e të shumta, me male te egra, por piktoreske, me liqene, me lumenj, në një kënd të Evropës që përbën bregun e detit perëndimor të Ballkanit. Me gjithë këtë, sheh njerëz të zbehur nga fytyra, të venitur nga sytë, të rreckosur nga rrobat, të palarë e të parruar, faqet të thelluara midis rreshtave të nofullave nga mungesa e ushqimit; qetë e lopët, kuajt e gjithë gjëja e trashë, të vegjël e të dobët. Nuk sheh asnjë vijë udhë të hekurt, as një liman të sistemuar, as fabrika, as pallate, as universitete, as spitale që të përfshijnë kushtet shëndetësore. Gjithashtu i huaji që na viziton nuk sheh as vepra arti, të vjetra ose të reja, me një fjalë, asgjë nga ato që shihen kudo në vende të qytetëruara. Vetvetiu këtij të huaji i vjen ndër mend pyetja: Pse ka mbetur kështu ky vend? (Mehdi Frashëri, Problemet Shqiptare, Antologjia e mendimit shqiptar 1870-1945,

edhe modestia gjithashtu.

– Gjatë trajtimit të materialit të bisedës me poetin shkodran, a keni menduar ndonjëherë se ai foli kaq shumë për vdekjen sa dukej se ai nuk dialogonte me kënd, por thjeshtë monologonte?

– Gjatë bisedës, natyrisht Rreshpja dialogonte me mua, por kishte raste që ai sikur i rrëfehej vetvetes. Mbeshtillej në botën e vet sa reale aq edhe surreale. Ai thoshte: "Fredri..." dhe kështu, sikur kallëzonte jetën e tjetërkujt që e njihte mirë dhe jo për veten e vet. Fjala vdekje s'mund të shmangej. Ai thoshte: "Fredri i mban me vete vdekjen dhe kapelen". Dukej se qe familjarizuar me vdekjen, që mund t'i vinte në çdo kohë, siç erdhi përfundimisht si tre muaj më vonë, më 17 shkurt të 2006-s.

Në anën tjetër, Shkodra e ngjizi Rre-

shpjen me poezinë e vet të ndritshme brenda shpirtit të saj kulturor, intelektual dhe ia dha Shqipërisë sikur t'i thoshte: "Rreshpja s'i përket vetëm Shkodrës, por krejt Shqipërisë". Por Shqipëria nuk veprroi si duhet me Rreshpen, madje veprroi me cinizëm, njëjtë si me Kutelin, Poradecin e plot të tjerë. Nuk arriti t'i dëshmonte Europës se poeti i shkëlqyer i Shqipërisë, i përkiste edhe asaj, d.m.th., Europës. Megjithatë, edhe në këtë mospdashje, në këtë errësi kulture, Rreshpja shkëlqen me poezinë e vet. Në libër e kam cilësuar "Napoleoni i butë i lirikës shqiptare". Poezia e tij s'është vetëm e sotshme, por është mirëfilli poezi që shpërfill kohët, kornizat dhe herdokur do i shfaqet Europës me cilësinë e poetëve që i duhen edhe asaj.



– Me Frederikun për Fredin folët kaq gjatë, u përmendën kaq emra. U kujtuat

botimet "Toena" Tiranë 2003, f.396). Në të njëjtën mënyrë gjykon dhe Ali Këlcyra. Sipas tij "mund të thuhet pa e tepruar se sundimi pothuaj 450-vjeçar osman nuk qe gjë tjetër veçse një pushtim ushtarak. Gjatë gjithë kësaj kohe vendi ynë jo vetëm që nuk bëri asnjë përparim në të gjitha shfaqjet (aspektet) e jetës kombëtare; përkundrazi mbeti prapa. Në fillimin e jetës së pavarur vendi ynë nuk kishte jo vetëm një rrjet rrugor për të qenë,

frë", Tiranë 2012).
Ja dhe një shkrim i gazetës "Drita" në vitin 1909, që besoj se ishte shkruar nga një jokomunist. "E fëlliqura Turqi shqiptaret i ka rrjepur e varferuar keq saqe mund të themi se varferi e vobesi si e shqiptareve nuk gjenet gjekundi. Pa shtëpi, pa gje, pa mesim e pa me të voglen shprese kane mbetur, edhe prap pagese të rende i paguajne Turqise e cila i merr ushtare qe të vejne e vdesin nga klima dhe shigjetat e Mahmut Jahja-it ne Arabi. As udhe s'kemi, as ura, as mesonjatore as ndonje te mire per vendin tone ka bere gjer me sot Turqia. Te gjitha te hollat qe mbledh i dergon ne Stamboll dhe çdo nepunesi te saj i ka dhene lejen te rjepe gjendjen ne çdo udhe te mundur..." (Gazeta "Drita" Nr. 86, dhjetor 1906).

Tani edhe faktet: Fillimisht theksojmë se çdo pushtues ka pasur si synim përfitimin e hapësirave të reja dhe unifikimin në terriore gjithnjë e më të gjëra. Por vetë pushtuesit kanë pasur nivel të ndryshëm qytetërimi dhe tradite, për rrjedhojë dhe pasojat mbi vendet e pushtuara kanë qenë të ndryshme.

Nën pushtimin romak u ndërtua rruga Egnatia, Apollonia e Ilirise qe qyteti me i madh ndër 20 Apollonitë që kishte atëhere, kishte shkollë të zgjedhur, ku mbaroi studimet vetë perandori Oktavian Augusti. Durrësi ishte njëri ndër qytetet më të mëdha në bregun lindor të Adriatikut. Amfiteatri i tij ishte më i madhi pas atij të Romës. Përsa u përket pushtimeve të tjera: ilirët dhe arbrit erdhën nën pushtime të huaja, sepse bota jetonte në perandori. Këtë fat paten dhe shumica e popujve të tjerë. Pas shkatërrimeve të barbarëve, nën bizantinët vendi e mori veten dhe pati nivel të njëjtë zhvillimi me popujt fqinj të bregut lindor të Adriatikut. Nën bizantinët: Durrësi, Justiniana Prima dhe Ohri qenë ndër qytetet më të rëndësishme të Perandorisë. Gjatë sundimeve bizantine, veneciane dhe serbe u zhvilluan komunat qytetare me statute; pati shkolla ne gjuhët latine, greke si në të gjithë Europën e kohës, deri në universitetin e Durrësit.

Pavarësisht nga këto të dhëna, duhet sqaruar se nuk ka pushtues të mirë dhe çdo pushtim shkon kundër zhvillimit të natyreshëm të një populli, por edhe midis pushtuesve mund të bëhet krahasimi për të parë kush ka qenë

më i keq.

Pushtimi turk: 95 përqind analfabetë. Zhvillim artizanal të shekullit XVI dhe në fund të shekullit XIX. Asnjë kilometër rrugë automobilistike.

Pushtuesit osmanë shkatërruan gjithçka gjetën dhe për pesëqind vjet nuk ndëruan asgjë, sa trashëgimia otomane sot është e kantandisur në ndonjë urë, hamam dhe objekte kulturi.

Pushtimi austriak: Në periudhë lufte, brenda 2-3 vjetësh ndëruan rrugët: Shkodër-Tiranë; Shkodër-Pukë-Kukës; portin e Shëngjinit; dekovilin Prizren-Kukës, qindra shkolla, dhjetëra qendra shëndetësore në të gjithë zonën e tyre të pushtimit, si dhe shume projekte te tjera, një pjesë e të cilave të mbetura përgjysmë pas kapitullimit.

Pushtimi italian: Rrugën Vlorë-Tepelenë-Përmet; rrugën Vlorë-Sarandë; portin e Vlorës. Pa përmendur Luftën II Botërore, kur Italia Fashiste ndërmori projekte të rëndësishme zhvillimi në infrastrukturë, arsim, shëndetësi, etj. Akoma më zi është gjendja në arsimin shqip gjatë periudhës otomane: Në vitin shkollor 1896-1897 kishte: shkolla greke: 1276 me 85015 nxënës; shkolla bulgare: 821 me 29846 nxënës; shkolla serbe: 162 me 7511 nxënës; shkolla rumune: 80 me 3678 nxënës. Vetëm shkolla shqiptare nuk kishte. Ishin deri në dhjetë shkolla që autoritetet osmane here i hapnin dhe here i mbyllnin. Pse na diskriminoi kaq keq Perandoria Osmane? Nuk vepruan kështu austro-hungarezët që na pushtuan vetë dy vjet. Me urdhër të Komandës së Përgjithshme Ushtrake Austriake arsimit fillor u bë i detyrueshëm për fëmijët 7-12 vjeç në fshatra dhe 7-14 vjeç në qytete. Në vitin shkollor 1916-1917, Tirana kishte 24 shkolla fillore me rreth 1000 nxënës e 39 mësues; Prefektura e Durrësit pa Krujë kishte 40 shkolla, me 1542 nxënës e 67 mësues; Prefektura e Elbasanit kishte 49 shkolla, 1750 nxënës dhe 61 mësues. (Hajrullah Koliqi, Historia e Arsimit dhe e mendimit pedagogjik shqiptar, Prishtinë 2002, f.327). Këto janë faktet, këto janë gjykimet e jo-komunistëve për periudhën osmane të shqiptarëve. Tash vetëm një pyetje? Si ju duket, a ngjajnë gjykimet e antikomunistëve dhe komunistëve në gjykimin e periudhës së pushtimit turk? Meqenëse ngjajnë, duket lënë anti-komunizmi se nuk mund të shërbejë si alibi për të mbrojt prapambetjen e shqiptarëve nën pushtuesit osman. Nuk mund të ecet me gjykime që nuk mbështeten në fakte, aq më keq që janë kundër fakteve.

– Keni ndonjë ide për t'iu rikthyer Frederikut, me ndonjë dramë, monografi apo roman, ndoshta për të thënë çfarë nuk u tha në librin "Frederik Rreshpja, që s'e kuptuam kurrë"?

– Jo. Absolutisht jo. Këtu fikcioni shpërfillet ndjeshëm, sepse Rreshpja rrëfeu mrekullisht dhe pangjashëm dramën e vet. Çdo vepër tjetër e zhanrit fiction (roman, p.sh), për Rreshpen do t'ish e zbehtë. Rreshpja, vetë e gdhendi personazhin Rreshpja n'atë rrefim dhe në poezitë e veta të mëhershme. Nëse, ndonjë regjisor i talentuar tregohet i vëmendshëm tek rrefimi i mbramë testament i Rreshpes, atëherë mund t'i përcillej shikuesit një dramë e përkryer. Unë kam besim se rrefimi i mbramë i Rreshpes do shihet si i tillë. Sepse ai rrefim dhe krejt poezitë e Rreshpes janë provokuese.

Bashkëbisedoi **Albert Vataj**

Si erdhi 7 Marsi, në shkollën 9 vjeçare “Dede Gjon Luli”, Hot i Ri

Eventet e ndryshme që kane institucionet shtetërore, siç janë festat, nuk kane qellim në vetvete vetëm për të festuar, por në radhe të pare për të bere bilancin e punës dhe marrjen e forcave të reja, për arritje më të mëdha për të ardhmen. Në këtë vështrim duhet shikuar edhe 7 Marsi për çdo shkolle e në veçanti për shkollën 9 vjeçare “Dede Gjon Luli”, Hot i Ri, për të cilën shkruajmë.

Nxitem të shkruaj diçka për këtë shkolle jo thjesht se kam kaluar vitet më të mira të punës si mësimdhënës aty, por sepse pjesa më e madhe e nxënësve dhe një pjese e mire e mësuesve të kësaj shkolle janë dukagjinas.

Pak histori

Në vitin 1926 erdhën hotianët dhe u vendosen aty ku janë sot. Blenë shtëpinë e Katrina Luc Nishit, që shërbeu si shkolle deri në vitin 1971. Shkolla e pare u hap në vitin 1931 nga mësuesi Palok Traboini. Në vitin 1974 u hap cikli i larte, që ishte në varësi të Grudes së Re.

Në vitin 1999 përfundoi së ndërtauri shkolle e re, dy katesh, me 17 dhoma mësimi dhe me një personel prej 20 mësuesish, duke qene shkolle 9 vjeçare, për fshatin Hot i Ri.

Pa droje, shkolle 9 vjeçare Hot i Ri mund të merret si etalon për të gjitha shkollat rurale të rrethit Shkodër ku punohet me përkushtim dhe rezultatet kane progres nga viti në vit dhe nuk i ka shumë problematika që i kane shumë shkolla të tjera simotra. Nuk do të bëjnë parade suksesesh, por do të cekim disa arritje, me të cilat vijmë në këtë 7 Mars. Tashme është krijuar tradite në zhvillimin e shumë veprimtarive kulturore-artistike dhe sportive brenda dhe jashtë shkollës, që kam qene prezent pothuajse në të gjitha. Për shumë vite kam qene pjesëtar i Këshillit Pedagogjik të shkollës dhe vitet e fundit si një ish që ftohet për çdo event, që shkolle ka. Përveç veprimtarive, që jepen here pas here para nxënësve dhe prindërve, konkurset e ndryshme apo ndeshje sportive midis klasave, nxënësit e kësaj shkolle janë përfaqësuar denjësisht nder vite baze rrethi e qarku, që nga Sarda, Oblika, Fushe-Arrezi, BluScy e të tjera, që kane zënë vende nderi, që e tregojnë kupat e shumta, të cilat janë ekspozuar në drejtorinë e shkollës. Në grupin artistik, përveç këngëve të interpretuara me nivel, që ka zënë vende nderi edhe në festivalin “Bilbilat e Shkodrës”, apo pjesëmarrja dinjitoze në formatin “Gjeniu i Vogël”, të emocionon grupi i valleve dhe veçojmë “Vallen e Mrizit”, me motive të vjetra, që grupi: Marçela Brahimi, Alfons Rrasa, Klaudio Vukaj, Renaldo Zojza, Adelajda Lugaja, Dorela Marashi dhe Eglantin Gjoka nuk mbeten mbrapa nga një grup profesionist apo ata që përgatit Aldo Nika. Për këtë merite ka edhe edukatorja Drita

Zefi, që e ka përgatit këtë grup. Për vitin 2015, që përkonte edhe me 100 vjetorin e vrasjes se heroit Dede Gjon Luli, pati shume veprimtari artistike dhe letrare, në poezi e drame të përgatitura nga mësuesit e gjuhës Jehona Çuku dhe Vitore Kodra. Për vitin shkollor e në vijim, mësuesit që përgatitin veprimtaritë artistike kane shtuar mobilizimin e pjesëmarrësve në këto veprimtari, që mos të bie cilësia e tyre edhe mbas daljes në pension të ish mësueses së muzikës znj Drande Marku, e cila kontribuoi për shume vite në këtë

me dekor figurative e pamor, me shume shije dhe i rifreskuar në vijimësi. Me forcat e tyre duke “Lypur” kane ndërruar orenditë nder klasa, duke zëvendësuar ekzistueset që ishin prej shumë vitesh. Të gjitha këto, në radhe të pare janë arritur në saje të përpjekjeve dhe njohjes të drejtorit, zotit Gjovalin Kodra.

Padyshim, që në radhe të pare për kolektivin e kësaj shkolle, është procesi mësimor, të cilit i shërbejnë edhe ato për të cilat shkruam. Në vijimësinë e një tradite të krijuar nder vite, prioritet mbi

Antonio Malshyti e të tjera. Pothuajse nuk ka analfabet të heshtur. Këto rezultate në procesin mësimor-edukativ kane ardhur në saje të mobilizimit maksimal të të gjithë mësuesve, përgatitjes së larte për orën e mësimi, aplikimit të metodave bashkëkohore mësimdhënie duke ju shmangur atyre tradicionale. Kësaj i ka shërbyer edhe kualifikimi i brendshëm apo atij lokal dhe kombëtar. Të gjithë pa përjashtim janë në nivelin e kërkesave të kohës, Aimiri, Vitorja, Jehona, Bruçaj, Shllaku, Arjeta, Suela, Elona, Ndoja, Alketa, Tafili, Marija, Katrina, Luçi, Milaci, Drita, Pranvera, Drinalda nga të cilët nuk mund të veçosh asnjërin. Ky mobilizim i kësaj trupe mësimore nuk ka ardhur nga kontrolli i institucioneve arsimore eprone lokale apo qendrore, i cili ka munguar me dekada, por nga ndërgjegje e tyre për të realizuar misionin e shenjte, që ata kane dhe në saje të drejtimin me profesionalizëm të drejtorit, zotit Gjovalin Kodra dhe zv-drejtore, zonjës Tule Ahi, të cilët gjate gjithë kohës kane qene edhe lider, edhe organizator te mire. Pra, jo vetëm që kolektivin e kane vene në pune, por edhe kane organizuar dhe matur punën e tyre në lendet dhe klasat, ku japin mësim, duke bere here pas here kontrole frytdhënëse. Shumë pozitivisht ka ndikuar në rezultate edhe fakti, se ka mbi 15 vjet që është ruajtur bërthama e kolektivit, ka pas lëvizje shume të pakta. Pozitivisht ka ndikuar edhe bashkëpunimi i çdokohshëm me bashkësinë e prindërve, duke kërkuar ndihmësen e tyre për zgjidhjen e të gjitha problemeve, që shkolle ka pasur, apo me pushtetin vendor të njësisë administrative, në territorin e së cilës është shkolle. Në çdo kohe, kjo shkolle udhëhiqet nga ligji “Për Sistemin Arsimor Parauniversitar të Republikës së Shqipërisë”, aktet normative, kontrata kolektive apo ligje të tjera, që rregullojnë sistemin arsimor

Me gjithë punën e bere, kolektivi mësues-nxënës i shkollës së Hotit të Ri, janë të ndërgjegjshëm, se në punën e tyre ka edhe probleme, edhe dobësi në asimilimin e dijeve shkencore nga një pjese e nxënësve. Interesimi i disa nxënësve për mësim nuk është i mjaftueshëm, prandaj është e nevojshme të përmirësohet puna me ta, duke rrit edhe bashkëpunimin me prindërit e tyre.

Sukseset e deritanishme, bëjnë një baze të shëndoshë për arritje më të larta në të ardhmen, ndërsa problematikat e deri tanishme dhe dobësitë do të jene një nxitje për rritjen, për të gjetur metoda më të frytshme me ata nxënës, që kane dobësi, në mënyrë që vitin shkollor 2015-2016 ta mbyllin me rezultate më të larta, në realizimin e objektivave, që kjo shkolle i ka vene vetes.

Prei SHYTANI



shkolle si instrumentiste, këngëtare, valltare dhe dirigjuese, të cilën është shumë e vështire për ta zëvendësuar denjësisht.

Veprimtaritë e këtij 7 Marsi kulmuan me konkursin e pikturës. Në këtë konkurs u ekspozuan punimet më të mira të nxënësve. Juria dha vlerësim për tre çmimet e para: Për David Mirashi, Jozefina Zefi dhe Xhuljana Carkaj. Nxënësit e kësaj shkolle për shume vite kane furnizuar ekipet zinxhir të akademive sportive të Shkodrës apo rrethinave, të cilët shquhen për cilësi sportive e vitalitet, që merite ka, në radhe të pare mësuesi i edukimit fizik, Dede Grima për zbulimin dhe përgatitjen e këtyre talenteve megjithëse në kushtet e mungesës së terrreneve sportive.

Sa here që të shkosh në këtë shkolle, shikon ndryshime. Që në pamjen e pare të shfaqet një mjedis që reflekton kulture. Oborri, me gjelbërim dhe i sistemuar me peme dekorative, frutore e ato për hije tradicionale, brenda dhe jashtë me lule të mirëmbajtura. Është e para shkolle me kamera sigurie të vendosura me forcat dhe kontributin e vete kolektivit të mësuesve. Korridore të mbushura

prioritetet ka qene dhe është realizimi i programit mësimor, në anën sasiore dhe duke përqendruar vëmendjen në anën cilësore. Me punën e bere, rezultatet kane pasur progres nga viti në vit. Është rast i veçante për këshillin e kësaj shkolle, që mësuesit e të dy cikleve kane të njëjtin mobilizim në procesin mësimor-edukativ. Në saj të kësaj pune, në ciklin e ulet rezultatet janë më të mira, sepse është sëmundje e përgjithshme që në ciklin e larte mobilizimi i nxënësve të vijmë duke u venitur, asimilimi i programit me i dobët. Megjithatë, edhe në këtë cikël ka arritje të kënaqshme, që këtë e tregon fakti, se ka disa vite që në provimet e lirit nuk ka pasur asnjë mbetës dhe ata që kane vijuar shkollën e mesme, kane pasur rezultate të larta. Me shumice janë nxënësit e kësaj shkolle, që përvetësojnë cilësisht dijet e dhëna në procesin mësimor, që mund të veçojmë disa nxënës të dhjetave absolute, Elizabeta Nika, Melisa Mirashi, Paolo Shtyllaj, Daniel Dedvukaj, Sara Hebjaj, Alberto Shtyllaj, Arsina Shpataj, Kledi Gjergji, Gerison Zhuri, Armela Kola, Olsi Mesi,

MENDIME RRETH RITEVE DHE TRADITAVE

Luigi SHYTI

1.

Duke udhëtuar në rrjedhën e shekujve shikojmë se janë krijuar, ruajtur dhe trashëguar tradita shumë të mira dhe të bukura që i kanë shërbyer komunitetit në jetën dhe marrëdhëniet shoqërore të tyre. Dallueshëm duken këto cilësi të malësorët tonë dukagjinas, si vlera të çmuara e të thella nga historia janë. Të tilla mund të përmendim; pjesëmarrja në kuvende dhe ndihma për zgjidhjen e problemeve, kushtimi për raste të jashtëzakonshme që kërkon ndihmë masive, për luftë për të mbrojtur territoret e krahinës apo vendit, për të ndarë vëlavrasjen apo gjakmarrjen brenda gjakut

ndërtimin e shtëpive, punimi a riparimi i urave, mullinjve, rrugëve të bjeshkës, të fshatit.

Respektimi i detyrave të ngarkuara nga familja e dhëndrit gjatë ceremonisë së dasmës apo edhe gjatë gjithë kohës që krushqit shkojnë për të marrë nusen. Respektimi dhe ndihma në punët e rastit, gjatë përgatitjes së pajës së nuses dhe ceremonisë së dasmës në familjen e vajzës, vënia në dispozicion dhe grumbullimi i enëve të kuzhinës dhe të ushqimit vullnetarisht nëpër lagje, ose kur kjo lagje është e vogël duhej të mblidheshin nëpër fshat.

Edhe në rastet e mortit kanë qenë dhe është një gatishmëri e jashtëzakonshme për kryerjen e ndihmave dhe

mon një tjetër, ti mund ti ndihmosh dikujt tjetër, mjafton që të zgjidhen problemet dhe kryhen punët brenda vëllazërisë.

Në dekadat e fundit një shumicë e madhe, si në shumë territore të Shqipërisë, edhe në krahinën e Dukagjinit ka lëvizur për në zona fushore, afër apo brenda qyteteve, por edhe jashtë shtetit duke u shpërndarë në shumë vende të botës. Ata kanë marrë me vete edhe ato ritë e tradita që kanë trashëguar, por në kushtet e reja jo të gjitha mund të gjejnë zbatim, ashtu siç ndodhë gjithmonë që përqafohen rite e tradita të reja në përshtatje me kushtet dhe vendbanimet e reja dhe pa tjetër lihen më një anë disa të trashëguara. Kështu ka ndodhur gjatë gjithë historisë dhe kështu do të ndodhë.

dita të reja. Por po kështu duhet të dalin nga përdorimi i zakonshëm i atyre riteve apo traditave të cilat nuk shkojnë për kohën, nuk janë të pëlqyeshme nga shumica e shoqërisë. Unë nuk them dhe nuk do të pranoja që traditat të zhduken, të harrohen. Do të ishte mirë që të gjitha, edhe ato që konsiderohen pozitivë edhe ato që konsiderohen të panevojshme, të regjistrohen në të gjitha mënyrat e mundshme dhe të ruhen në arkiva, muze, në shkrimet në të gjitha format e tij, që brezi i ri dhe brezat që vijnë ta dinë kush kemi qenë, çfarë vlerash kemi pasur, cilat qenë të dobishme dhe cilat nuk i shërbejnë më shoqërisë, por të ruhen si relike të historisë.

Ka shumë raste që rregullohen rrugë



Foto e viteve '30

apo fisit, për të ndihmuar fqinjët; lidhja dhe bashkëveprimi shoqëror, si gjuetia, thirrja e nuseve, darkat apo drekat në festime e ceremoni të ndryshme, të cilat nuk janë të pakta.

Po ashtu mikpritja, besa, vendosmëria, përgjegjësia kolektive në të mirë të fshatit apo krahinës e kombit, respektimi i të afërmeve, gjakut, shokëve, miqve, respektimi i vendimeve kolektive të fshatit apo krahinës, rregullimi i kroit të lagjes apo fshatit, rregullimi i rrugës së kroit, mullirit apo vendpushimi i lagjes apo fshatit, vendosja dhe rregullimi i kryqeve. Ka pasur edhe gjueti të përbashkët, ndërtim furrash dhe prodhimi dhe transporti i gëlqeres. Nga thellësia e moteve kanë ardhur tradita të mira në marrëdhëniet shoqërore si, ndihma reciproke në punët bujqësore, ndërtimi i shtëpive të reja, rindërtimi i shtëpive të shkatërruara nga forca madhore, dalja dhe ulja prej bjeshke, transporti i bazës ushqimore për bagëtitë, transporti i lëndës së drurit për

shërbimeve në këtë rast. Ndhima në shpërndarjen e lajmit në mort, pa marrë para sysh varësisht e kushteve të motit dhe terrenit, ndihma me njerëz për të përballuar punët gjatë ceremonisë mortore, mbështetja morale dhe materiale për të përballuar nevojat në këto raste duke ndihmuar me bukë, djathë, mish, raki e verë, gatishmëria në të gjitha kërkesat e familjarëve që kanë mortin, varrosja e personit të vdekur dhe shërbimet për përgatitjen e varrit, etj. me respekt dhe të gjitha vullnetarisht.

Natyrisht, të gjitha ndihmat dhe punët që bëheshin dhe bëhen akoma në këto zona nuk paguhen, pra përballohen vullnetarisht, thjeshtë, ruhej dhe ruhet një detyrim shoqërore reciproke, por gjithmonë pa urdhra dhe sipas mundësive fizike e njerëzore, me parimin se "këto janë për derë". Asnjë herë nuk ka qenë dhe nuk është e thënë se detyrimisht, atij që i ke ndihmuar duhet që pa tjetër të të ndihmojë në raste të tilla, dikujt i ndih-

Nuk ka asgjë për tu shqetësuar. Natyrisht do të mbijetojnë ato që janë më të mirat, më të bukurat dhe që i përshtaten edhe kohës dhe vendit. Do të mbijetojnë ato që tregojnë gjenezën e një populli, kulturën dhe historinë e tij. Kjo duhet të jenë parasysh dhe është mirë që të ruhen. Në kohën që jetojmë, kur ruli i globalizimit po vepron vrullshëm, do të shuhen ato komunitete, ata popuj, të cilët nuk njohin historinë e tyre, nuk kanë se çfarë ti japin shoqërisë.

Është shumë bukur kur shikon që banorët e rinj duan që të merren me punët kolektive të lagjes, apo rrugës në vendet ku janë vendosur.

Koha ecën përpara ka zhvillime e përparime e nga kjo krijohen rite dhe tradita të reja, e për pasojë lihen më një anë apo edhe harrohen ato që nuk i shërbejnë më shoqërisë, komunitetit. Në çdo periudhë të zhvillimit të shoqërisë është e domosdoshme që të krijohen marrëdhënie të reja, nga të cilat zënë fill edhe rite e tra-

të lagjes, pastrohen rrugë e kanale në vendbanimet e reja kolektive, shikon gra e burra që pastrojnë rrugët në mjedisin e lagjes, shtrijnë, riparojnë e mirëmbajnë rrjetin elektrik, mbajnë pastërti në teritorët, ndihmojnë njëri tjetrin në raste të ndryshme. Të gjitha këto marrëdhënie janë krijuar dhe po krijohen edhe pse shpërndarja është bërë e madhe dhe janë vendosur në një territor banorë nga krahina të ndryshme, por kanë gjetur dhe po gjejnë mundësinë e bashkëpunimit me njëri tjetrin. Ekziston përgjegjësia kolektive për një jetë më të mirë. Kjo është tregues i integritit dhe zhvillimit në vendbanimet dhe lidhjet e reja që po formohen. Respektohet tavolina, dreka apo darka që organizohet, ka respekt reciprok midis të pranishmëve në tavolinë, etj.

Gjithnjë e më shumë po shikohen veprime dhe manifestime të reja në jetën e komunitetit tonë kudo që është vendosur. Kjo shikohet në jetën e përditshme,

“10 PERSONAZHET SHKODRANË TË VITIT 2015”

Është privilegj të jesh mes miqëve të artit, miqëve të pendës e krijuesëve të rinj, të cilët kanë treguar gjithnjë interes dhe përkushtim të veçantë.

Për të tretin vit radhazi Agjencia e Spektakleve “Buna 1” me producent dhe president z.Arben Mazi, organizoi në qytetin e Shkodrës një mbrëmje gala në lokalit “Kurora e Artë”, një angazhim afirmues për të nderuar personazhet më të spikatur publikë të këtij qyteti, të vitit që lamë pas, për kontributin e tyre në vite në fusha të ndryshme sociale, kulturore dhe artistike të jetës, ata që na emocionuan dhe na nderuan me punën e tyre gjatë gjithë vitit, jo vetëm në Shkodër, por edhe jashtë saj.

Për disa javë me radhë ka qenë publiku që ka votuar në adresën e internetit të kësaj agjencie për figurat më të shquara si: shkrimtari më i mirë i vitit, fotografi artistik më i mirë, këngëtarë më i mirë, sportisti më i mirë, biznesmeni më i mirë, politikani më i mirë etj. Risia e këtij edicioni të tretë të “BEST 10 NORTH” 2015, filloi që në hyrje të lokalit, duke u duartrokatur nga të pranishmit, u bë parakalimi në tapetin e kuq i personazheve të kësaj mbrëmje.

Salla e lokalit “Kurora e Artë” me një publik të zgjedhur u bë pjesë e kësaj mbrëmje gala të ndarjes së çmimeve, të organizuar jo si një ceremoni solemne, por si një spektakël që do ta bënte atë të këndshëm e impresionues.

Një spektakël, i cili që nga momenti që është vendosur në skenë edicioni i parë, pati një sukses dhe vemendje të menjëhershme. Edhe këtë vit ndodhi e njëjta gjë, si në procesin e votimit, ashtu vazhdoi deri në fund të spektaklit.

Drejtuesit e këtij spektakli, moderatorët Siçiliana Mazi dhe Blendi Kola, i uruan mirëseardhjen pjesëmarrësve të ftuar, si dhe shikim të këndshëm telespektatorëve që po ndiqnin nëpërmjet ekranit të TVSH edicionin e tretë të “Best North 2015”, të cilët po e pritnin me padurim startimin e kësaj mbrëmje vërtetë të bukur.

Ishte një natë e gjatë, u ndanë plot trembëdhjet çmime, ku tetë prej tyre ishin votuar nga vetë publiku dhe pesë të tjerë u dhanë nga Agjencia e Spektakleve “Buna 1”.

Larmishmëria e çmimeve ishte veçanta në këtë natë gala, pasi brenda një spektakli ishin përfshirë arti i shprehur me muzikë, pikturë, biznes, politikë, sport e shumë të tjerë.

Është me të vërtetë diçka e bukur kur njeriu vlerësohet për punën që bën dhe merr një çmim, i cili votohet nga publiku.

Ashtu si vjet çdo personazh ishte i ndarë në kategoritë përkatëse të fushës që ata ushtrojnë dhe mbas kandidimeve

të cilët kanë qenë të afishuar në eëbsitin eëë.buna1.net, u bë edhe vlerësimi i punës së tyre.

Piktori më i mirë i vitit u shpall z.Nikolin Luca, Shkrimtarja më e mirë Vera Sakaj, Talenti i ri Nelidon Pepushaj, Fotografia artistike më e mirë Brigela Demaj, Këngëtarja më e mirë Orjeta Kelaj, Sportisti më i mirë Nelson Hysa, Biznesmeni i vitit Frang Podja, Kryebashkiakia e Bashkisë e vitit Voltana Ademi, Politikanja e vitit Irma Kopliku dhe Filantropja e vitit Diela Ana Preka, të cilës ikona e televizionit shqiptar Silvana Braçe, i dorëzoi çmimin; për kontributin e saj që ka dhënë për shtresat në nevojë dhe për mbështetjen ndaj artit.

Agjencia e Spektakleve “Buna 1” shpalli edhe disa vlersime të veçanta ku emocione krijuan tek të pranishmit çmimet e karrierës për të ndierin Bik Ndoja dhe aktorin e humorit Paulin Preka, si dhe

duke i dorëzuar çmimin boksierit Nelson Hysa u shpreh: „Në Shqipëri ka shumë kampion, por Shkodra prodhon pafundësisht. Kampion si Nalson Hysa; shtatëmbdhjet herë kampion i Shqipërisë, dhjetë herë Kupon e Republikës, tri herë kampion ballkanik. Djali që ka dhënë shumë për Shkodren, ndaj e meriton çmimin.

Njëkohësisht ai falenderoi edhe Agjencinë e Spektakleve „Buna 1” me President z.Arben Mazi.

Ky aktivitet u shoqërua edhe me këngë me pjesëmarrjen e këngëtarëve Orjeta Kelaj, Adelina Corraj, Islia Ademi, Nimet Leka dhe Elsidia Sina. Një larmi të veçantë këtij aktiviteti i dhanë edhe humoristët profesionistë, aktorët e Estradës së Teatrit „Migjeni” Besnik Çinari dhe Drande Khai.

Në mbyllje, Kryetari i Këshillit Bashkiak Shkodër z. Xhemal Bushati i dorëzoi titullin „Mirënjohja e Qytetit” Presiden-

cila do t’ju shërbejë për ambicje të reja në fushën intelektuale dhe krijuese, si dhe premtoi se aktivitete të tilla nuk do të mungojnë asnjëherë.

Nuk është e tepërt të themi se; që nga viti 1998 Agjencia e Spektakleve „Buna 1” ka realizuar mbi dyqind e dyzet spektakle, njëqind prej tyre në bashkëpunim me Bashkinë Shkodër.

Ishte e pamundur që për këtë aktivitet mos të merrnim edhe opinionin e shkrimtarit dhe dramaturgut të shquar prof.Fadil Kraja: „Ceremonia manifestive që organizon z.Mazi për dhjetë shkodoranë më të suksesshëm të çdo viti, është ndoshta një ndër ngjarjet më të bukura kulturoro-artistike që bëhen në Shkodër dhe është bërë e dashur dhe e këndshme për të gjithë, sepse lançon vlerat, talentët shkodoranë në çdo sferë të jetës shoqërore, politike, artistike, kulturore, sportive, ekonomike etj. Një festë që nisi me marrjen e mendimit qytetar përmes internetit dy muaj më parë dhe përfundon me shpalljen e fituesëve. Pra, një manifestim popullor dhe që tërheq vemendjen qytetare.

Do të kisha një propozim për të ardhmen. Do të ishte shumë më interesante dhe joshëse nëse përveç çmimit moral, të kishte edhe një çmim material. Sado simbolik. Një biçikletë, një kompjuter, një televizor, një pushim dhjetë ditë në një nga hotelet e Velipojës etj. Për këtë do sponsorizonin shumë firma dhe biznese, sepse kjo do të ishte edhe një reklamë me efekt perfekt. Pse jo edhe Bashkia e Shkodrës të merrte pjesë në ndonjë çmim“.

Edicioni i tretë i „Best 10 North” që u organizua në Shkodër nga Agjencia e Spektakleve „Buna 1”, ishte në bashkëpunim me radio televizionin shqiptar.

Skenografia ishte realizuar nga Hysni Halili, fonia nga Bledi Doçi, ndriçimi nga piano event system dhe grafika nga Valmir Hysaj.

Moderatorja dhe ideatorja e këtij spektakli Siçiliana Mazi, përveç të pranishmëve, falenderoi të gjithë televizionet lokale: Si TV1 Channel, Star Plus, Antena Nord, TV Rozafa dhe TV Kopliku për publicitetin që i bënë këtyre personazheve rreth një muaj të tërë. Gjithashtu falenderoi ata që e mbështetën për realizimin e këtij spektakli, Abcom dhe firmen Berttoni, Beauty Center Star, Familjen e z.Astrit Meshnuni dhe pronarin e restorantit „Kurora e Artë” z.Artur Lushi për kontributin e tyre.

Agjencia e spektakleve „Buna 1” mbyll kështu një edicion tjetër të suksesshëm të „BEST 10 NORTH”, duke premtuar që vit pas viti të sjell të tjera risi dhe surpriza.

Ramazan ÇEKA, Shkurt 2016



çmimi i mirënjohjes për veteranin e atletikës Vildan Tufi.

I veçantë ishte çmimi i karrierës. Nuk kanë reshtuar nostalgjitë, vështirësitë, arritjet në skenë të qindra roleve, të cilat edhe pse kanë kaluar mbi tetë dekada jete, janë të freskëta në mendjen e gjithsecilit. Askush nuk mund ta harrojë një emër si Paulin Preka, i sili këtë natë kishte ardhur nga Italia në Shkodër vetëm për të nderuar popullin shkodoranë.

Çmimi i mirënjohjes është një çmim që nuk ka munguar asnjëherë në Best 10 North, për shkak se Shkodra ka shumë artistë apo sportistë të cilëve duhet t’i jemi mirënjohës për atë çka i kanë dhënë Shkodrës dhe më gjërë.

E bija e Bik Ndojës tha se magjia e Bik Ndojës do të mbetet e pavdekshme.

Paulin Preka në fjalën e tij, i cili u duartrokoi disa herë, ndër të tjera tha: „Ne kemi bërë humor në kohën kur ju në shtëpiat tuaja nuk keni pasur as buken e gojës dhe iu kemi bërë me qesh. Kolegët e mi janë pikantë“.

Ndërsa Deputeti i LSI z.Agron Çela,

të Agjencisë së Spektakleve „Buna 1” z.Arben Mazi, për kontributin e veçantë dhe të vazhdueshëm për promovimin e vlerave më të mira artistike e kulturore të qytetit të Shkodrës në arenën kombëtare dhe ndërkombëtare.

Këtë mirënjohje e kishte marrë që në vitin 2014, por z.Mazi e kishte menduar si diçka personale, prandaj nuk e ka bërë publike, por me që ishin në ndarje të çmimeve iu duk momenti më i përshtatshëm për ta publikuar.

Z. Arben Mazi i morëm edhe një intervistë ku ai u prononcua duke na thënë se: „Në këtë kaos të vlerave të vërteta që duket sikur na ngërthen gjithnjë e më shpesh, mundohemi që me punën tonë të mbajmë të ekuilibruar vlerat intelektuale. Ndaj, nominimet dhe më pas ndarja e çmimeve për personazhet më të mirë të vitit, në një farë mënyre është vlerësim për artistët e dëshmuar që afirmojnë kulturën, artin, cilësinë intelektuale dhe nëpërmjet tyre mbarë shoqërinë tonë“.

Ai falenderoi pjesëmarrësit, përgëzoi të nominuarit për punën e shkëlqyer, e

Amina Meshnuni, shkrimtarja me të ardhme të kthjelltë si loti...



Në një ditë të veçantë, si kjo e sotmja, për një krijuese nga më të rejtat, siç është rasti i shkrimtares Amina Meshnunit është një kënaqësi, po ashtu e veçantë, të shijosh promovimin e një vëllimi, me poezi e prozë poetike, si "Sy që nuk vdesin" të saj, si një vlerë artistike tejet e arrirë. Aspak për komplimentin e merituar, por shtyrë nga obligimi profesional, rrjedhojë e një kënaqësie të jashtëzakonshme estetike, që më ofroi ky libër i ditëve të fundit, i Amina Meshnunit, edhe pse në një moshë shumë të re, vlerësoma më shumë se kurrë në jetën time, si studiues, thënien e filozofit, eseistit dhe kritikut të mirënjohur, amerikan, Xhorxh Steiner: "Shkrimtari bën gjysmën e punës, kurse pjesën tjetër të veprës ia beson kritikut si një lexues me laps në dorë".

Pse e kujtova këtë thënie, do të pyesni? Sepse sinqerisht gjithë kompozimi i librit në fjalë, me poezi dhe prozë poetike, një vëllim nga më elitaret, duke thyer skemën tradicionale të kompozimit, pra, thjesht, me poezi apo prozë, vjen mes nesh si një vlerë-identitet më vete, falë një vizioni estetik, postmodern, shprehje e një pasioni krijues, sui-generis, që autoren e rendit me poetët dhe prozatorët shqiptarë, me një të ardhme fatlume. Në epokën tonë të postskemave, thyerja e skemave tradicionale në kompozimin e veprës letrare si tërësi, kodi estetik, postmodern, si filozofi krijimi dhe mesazhi që ajo përcjellë dëshmojnë shkallën e lartë të një standarti elitare, të një veprë letrare si vepra në fjalë. Kështu, nëse, për lehtësi studimi, kritikun letrar "detyrohet" t'i vesh "kostumin kombëtar", ajo faktikisht, pra profesionalisht, nuk mund të jetë ndryshe, vetëm si një pasuri me "kostumin" e saj si vlerë universale. I tillë vjen sot, mes nesh, edhe libri më i ri "Sy që nuk vdesin" i Amina Meshnunit. "Sa më universale të jetë një vepër letrare, aq më pak i duron zinxhirët e gjinive, nënvizon eseisti dhe kritikun italian Aleksandro Piperno.

Duke manifestuar një dashuri të pazakontë për librin, si lexuese aktive, ndryshe si një nga ata "tipat e mërziqshëm", me kartelë biblioteke që në moshën 10 vjeçe, të cilat do të rrinin me orë të tëra para detit dhe që sekretet ia thonë vetëm hënës...". Amina, përmes gjuhës së saj poetike, sa të sentimentit dhe po aq të intelektit, mund të pohojmë, me dinjitet profesional, se ia ka arritur të rrokë një regjistër poetik për t'ia patur zili krijues

nga më seriozët... A nuk janë të tilla vargjet? Diçka më habit "Urrejtja, / Inati. / Ato kurrë s'kanë qenë të afta / Për art dhe poezi."

Poezia "Shkruhet me dashuri të djezur, Dashuri të fshehur. / O, e bukur, / Ti je poezi!"

vargje, rreptësisht kurnacë në verbin e tyre, që të vendosura në vargun e lirë, vinë në këtë vëllim, si një realitet estetik, postmodern, që rrok përkryerjen, duke u prezantuar si një dëshmi e kthjelltë e formës së çliruar, plotësisht, nga diktati i përmbajtjes, ndryshe si art postmodern. Aspak rastësisht, por me gjuhën e saj poetike, nën peshën e një kodi elitare komunikimi me fjalën dhe lexuesin e vet, ndryshe, si për të pohuar se nuk ka letërsi të shëndetshme pa shëndetin e plotë të doganës së letrave, kritikës letrare si filozofia e artit, pa të cilën, siç shprehej Shileri 150 vite më parë, nuk do të mund të shpëtojmë nga letërsia masive e turmave, apo ajo e realizmit "të orientuar", në letrën drejtuar redaktorit të librit "Sy



që nuk vdesin", z.Bedri Islami, autorja shprehet: "Ne kemi rrugë pa fund, vendmbërritje vetëm një. Është e çuditshme, kur mendoj se fati ekziston, ose se fati jemi ne, sepse ne ndryshojmë veten. Ne nuk ndryshojmë dot rrugën, por këpucët (lexo mjetet, kodin estetik) me të cilat e kalojmë, dhe kjo përbën një ndryshim të madh". Me një elegancë estetike, të pangjashme për moshën e saj të jetës dhe të krijimit, falë një kodi estetiko-filozofik, tejet elokuent, ajo na prezanton kredon e saj, poetike, si okelion e vëllimit "Sy që nuk vdesin", si një rrekje elegante, në tentativë për të rrokur objektivin e saj estetik, si krijuese, ndryshe materien e saj sublime, fjalën si vlerë universale: "Me të shikoj eklipsin / Të verbohem me dëshirë. / Më vrit sa jam në këmbë / Që të vdes e lirë."

"Nëqoftëse ndonjë gjë është më e forte se fati, është pikërisht guximi që e duron atë, pa iu trembur syri" shprehej poeti i shquar gjerman Emanuel Giebel. Ndonëse ndaj Aminës sonë, fati i jetës do të tregojë vrashtar, që në vitet e para të jetës saj, duke e privuar nga njomështia e dashurisë prindërore të babait, megjithatë, kjo dhimbje, kurrsesi nuk arriti ta mbyllte dot në vetvete. Përkundrazi, kjo gjurmë e pashlyer në shpirtin e saj,

do të transformohej në një akt sublim, në dhimbjen si vlerë universale, ndryshe si pohim dashurie dhe respekti për njeriun, babain e saj, Astritin që do të linte pas tre fëmijë të mrekullueshëm me gjysmën e vet, Pranverën, si kod ripërtëritjeje morale dhe jete, si kodi i pohimit të përjetshëm të vlerave të identitetit, që vazhdojnë ta trashigojnë, si kod malli dhe dashurie të pashoqemes tyre, gjithnjë të motivuar për të qenë gjithsesi vetvetja: Ç'mrekulli njerëzore për ta patur zili në kontekstin e dhimbshëm të krizës totale brenda familjes shqiptare! Ja si shprehet brishtësia e shpirtit në kodin e prozatorës Meshnuni:

"Të mbaj mend të vogël. Aq mikroskopik, kur zgjatesha në majë të gishtave dhe të ledhatoja kokën e bukur. Të mbaj mend me yje në sy, me galaksi të tëra në rrokjet e të qeshurës tënde. Udhëtonim unë dhe ti në gjithfarë fantazish dhe nuk kishim frikë kurrë nga rruga e hapur. Ishim bashkë. Të mbaj mend kur m'i hiqje këpucët, sapo kthehesha nga shkolla, kur

gjenialiteti krijues nga më të pabesuarit, për moshën e saj:

"Po ecja, siç eci zakonisht me turmat që gumëzhijnë nga të katër anët. Pashë një trëndafil në tokë. Ishte i tharë, i shtypur, i pluhurosur sikur universi e kishte hedhur tutje, hidhëruar nga koha që e kishte lënë për rastësinë. Më kujtoi atë historinë, ku ajo vetëm e dëgjonte dhe ai fliste plot pasion, sikur po zbrëthente teorinë e universit. Ndoshta në një dimension paralel ata mund t'i kishin shkëputur një minutë botës dhe ta çakordonin nga ritmi përfekt, t'i vidhnin ca nota mbi piano dhe të kërcenin si askush asnjëherë e asnjëherë më parë. Gjenialiteti i Marrëzisë..." Ja muza poetike, falë së cilës, në rrethanat nga më tërëndomta deri tek ato më aburde të jetës, merr jetë gjenialiteti estetik, si dimension universal i fjalës. "Takimi" rastësor në një kockë kali, gjatë një shëtitjeje në bregdetin Adriatik, do të bëhej shkaku i asaj muze që solli në jetë romanin tim "Gjenerali i ushtrisë së vdekur", do të shprehej Kadare. Ky është edhe kodi i artit postmodern, falë të cilit errësira, si boshllëk, kthehet në dritë edhe dhimbja në shpirt kthehet në vlerë universale. Krejt ashtu, si një standart i racës së poetëve dhe prozatorëve të mëdhenj, si një shans i lumtur për plotësimin e vetvetes, në praninë e një muze e cila nuk arrin që të ngopet, ashtu si gratë shtatëzëna në Greqinë e lashtë, që rrotulloheshin rreth statujës së perëndive me shpresën se embrioni në trupin e tyre do të thithte diçka sublime, diçka nga shëmbëlltyra e tyre, Amina i rikthehet vetvetes, dashurisë dhe krenarisë që i ndez në shpirt shëmbëlltyra e të atit, Astritit: "Sa njerëz shoh unë, turma pa fund e sa pak më duken të vegjël shumë. Zakonisht ne jemi njerëz, jemi të vegjël, jemi turmë. Nganjëherë amorfe. E pastaj është hija jote, që shtrihet në portretet

e vogla që lë pas, që rri e gjallë si forcë dhe mban qiellin me shpatulla të gjëra krenarie, si Atlas.... Babi, ne vazhdojmë të ëndërrojmë në konturet e maleve që ngrite! E themi: "Jeton!". Jeton, se të shoh gjithkund, ti jeton tek unë, ti jeton kur unë ngrihem të luftoj me mrekullinë e e faktit që ishe mes nesh, ti jeton kur unë jam në errësirë dhe rruga jote ndizet me pishtarë...Ti jeton kur unë them me krenari: "Jam bijë e një legjende!...Ti jeton!"

Pikërisht nga një rrethanë e tillë përjetuese, si kushtim i shpirtit, mori jetë edhe titulli i librit "Sy që nuk vdesin". Nëse, personalisht, mbeta shumë i kënaqur nga ky libër i Aminës, nuk di se sa Amina ndjehet e lumtur, brenda vetes, nga fjala ime, nën trysinë estetike të një figuracioni të pasur, koncizitetit të stilit, muzikalitetit të vargut, sfondit piktoresk të prozës, intensitetit emocional, frymës mistike të verbit dhe thjeshtësisë gjeniale të shprehjes poetike, përmes të cilave ajo shtegton, qartazi, drejt statusit të një shkrimtareje me të ardhme të kthjelltë si loti, ndryshe drejt një letërsie të madhe.

Shumë faleminderit Amina!

Faleminderit të gjithëve për vëmendjen e treguar!

Kadri Ujkaj, kritik letrar

PËR KOHËN E LIRË

10 HISTORI TË PABESUESHME, KUR KAFSHËT JANË ARRESTUAR NGA POLICIA

1. Macja që u arrestua për kontrabandë telefonash në një burg rus

Në qershor të vitit 2013, një mace kriminele u arrestua nga policia pasi u kap duke u përpjekur të fuste telefona celularë dhe ngarkues në një burg rus. Macja tepër e aftë për t'u ngjitur nëpër mure nuk arriti t'i shpëtonte syrit të policëve.



2. Dhitë u arrestuan se dëmtuan makinën e policisë

Tre dhi u arrestuan nga policia pasi akuzoheshin se kishin dëmtuar makinën e policisë. Kafshët u morën dhe u vendosën në kafaz, pasi autoritetet indiane u mërzitën me vandalizmin e tyre të vazhdueshëm.



3. Gomari që u burgos për sulm ndaj njerëzve

Në vitin 2008, një gomar që lloi dy burra pranë një ferme në qytetin Chiapas të Meksikës. Ai u fut në qelitet që përdoren për të mbajtur njerëzit e arrestuar që shkaktojnë çrregullime publike. Personi në pronësi të gomarit pagoi 420 dollarë gjobë



4. Lopa u arrestua për një rast vrasjeje

Një lopë karnavalesh u përfshi në një rast vrasjeje që përfshiu disa të rinj në Sango Ota, në jugperëndim të Nigerisë. Kurt ë rinjtë u mblodhën për karnavale, një zënkë shpërtheu mes tyre, duke përfunduar me vdekjen e një 24-vjeçar. Gjithkush u largua nga vendi i ngjarjes, dhe policia gjeti vetëm lopën.



5. Një dhi u arrestua pasi hëngri disa lule

Pronarët e dhisë me emrin Gary, punësuan një avokat për ta marrë në mbrojtje pasi policia e akuzoi se kishte ngrënë disa lule. Lulet nuk ishin dosido, por ishin të Muzeut të Artit Kontemporan në Australi. Megjithatë dhia u lirua në mungesë provash.



6. Cjapi që u ndalua për grabitje me armë

Në vitin 2009, policia në Nigeri ndaloi një cjan mbi dyshimin e një grabitjeje të armatosur në tentativë. Disa persona e morën cjanin dhe e çuan në polici duke thënë se ishte një grabitës i armatosur që kishte përdorur magjinë e zejë për të transformuar veten në cjan e për t'i shpëtuar arrestimit.



7. Pëllumb që u mbajt në Indi nën akuzën e spiunazhit

Në vitin 2010, policia indiane mbajti një pëllumb nën mbikqyrje pasi dyshohej se shërbente si spiun për një mision në Pakistan. Pasi zogu i bardhë u kab nga një banor në Indi, u dërgua menjëherë në një stacion policor. Pëllumbi kishte unazë tek këmbët dhe një numër telefoni të stampuar në trup.



8. Majmuni që u arrestua në Pakistan pasi kaloi kufirin indian

Besojeni apo jo, në vitin 2011, autoritetet në Pakistan arrestuan një majmun që po kalonte kufirin nga India. Banorët lokalë në fillim u përpoqën ta kapnin majmunin, por arriti t'i ikte. Ishin autoritetet ato që e neutralizuan kafshën.



9. Elefanti hyri në gjyq pasi vrau tre njerëz në Indi

Incidenti me Ramchandran (emri i elefantit) ndodhi në Kerala në janar të vitit 2013. Gjatë një festivali fetar, elefanti papritur filloi të masakronte njerëzit. Tre gra mbetën të vrara. Pas kësaj elefanti u arrestua dhe u mbajt në survejim të plotë.



10. Një tjetër mace arrestohet përsëri për kontrabandë në një burg brazilian

Një mace u kap në bazën e një burgu në Brazil me mallra kontrabandë për të burgosurit të cilat ia kishin lidhur me ngjitës në trup. Macja e bardhë u kap duke kaluar në portën kryesore të burgut. Macja u dënua në një qendër kafshësh lokale.



Mblodh Ndue SANAJ

572 vite besëlidhje dhe besëprerje!

Shqiptarët arritën të shporrin Turqit, koloninë Austro-Hungareze dhe Nazi-Fashizmin, por nuk shporrën

kurrë Komunizmin, të shndërruar në një Despotizëm tranzit. Shqiptarët sot gjenden në një zhgënjim total, në një mjerim makabër, në një poshtërim përtej ç'njerëzores, nga një frustrim i dijeve dhe ideve që nuk

vlejnë për asgjë. Të pashpresë dhe të çorientuar totalisht, tamam si mizat e spërkatura nga dezinfektimet shokuese. Shqiptarët e humbën fillin, nuk e kuptojnë më se çfarë do të thotë fjala shpresë dhe, a do mund të egzistojë ajo, në një tunel të mbushur plot me errësirë dhe mjergull!? Sepse shqiptarët nuk janë më të gjallë, por të mpirë dhe të vdekur. Megjithë këto padrejtësi që kanë ndodhur dhe po ju ndodhin çdo ditë, do t'ju nevojitej vetëm një drejtim, një rrugë, një qëndrim, ajo e revolucionit demokratik. Shokimi, mpirja, mjerimi,

poshtërimi dhe totalitarizmi, do të merrnin fund dhe tunelit do t'i hapej rruga e dritës së diellit, me shpresa impresionuese për një jetë më të mirë. Sepse shqiptari i shekullit të ri, apo shqiptari social-komunist i konvertuar në feudal-demokrat, janë po e njëjta gjë, i njëjti konstrukt. Dhe pse vallë egziston lufta shumë e madhe midis mentaliteve, kulturave të ndryshme, dinakërisht, intrigash, pabesive, tradhtive, kur jemi e njëjta mbetje? Apo mos ndoshta sistemi do një luftë kaotike midis brezash,

ku përveç nostalgjisë për dikë dhe diçka, të kthehemi padashur në armiq ideologjik të përbeuar midis njëritjetrit? Ky është shqiptari i sotëm? Apo ata shqiptarë që ditën të mitizojnë dhe nuk ditën të çmitizojnë? Që ditën të betonojnë dhe nuk ditën të zbukurojnë të ardhmen e tyre? Që mësuat të vrasin dhe të presin për krenari nderesh apo moralesh të fjalëve shterpë dhe nuk mësuat kurrë të japin jetën për Atdheun e tyre? Ky është shqiptari vallë, në të vërtetën e historisë sonë? Ky është njeriu besëdhënës, mikpritës dhe drejtësi-dashës? Ky është pasardhësi i Gjergj Kastriotit, i Nolit, i Fishtës, i Konicës, i vëllezërve Frashëri, i Ismail Qemalit dhe i të gjithë Atdhedashësve që nuk kursyen asgjë për këtë vend? Këta janë shqiptarët e sotëm. Që midis besëlidhjes dhe besëprerjes, i ndan një hapsirë e madhe intrige dhe paragjykimi. Ku interesi material, frika e humbjes së ekonomisë, mënyra e doktrinës së vjetër, të mpirjes momentale dhe frikës së reagimit, i kanë bërë të heshtur

dhe të strukur në ndonjë cep, ku përveç thashethemit dhe dallaveres momentale, nuk dinë të shpresojnë për diçka tjetër më të mirë. Prandaj, kush thotë se shqiptarët janë besnikë, e ka të kot. Sepse midis besëlidhjes

dhe besëprerjes, qëndron shqiptari i shekullit të sotëm, ku nuk di të sakrifikojë asgjë për të ardhmen e vet dhe të brezave që do të pasojnë më pas. Por di vetëm të klasifikojë idhuj dhe dinasti politike, duke haruar kështu heronjtë e vertetë të Shqipërisë.

Aleksandër RREMA



poezi *** poezi *** poezi *** poezi *** poezi *** poezi *** poezi *** poezi *** poezi *** poezi ***

**TI JE RINGJALLJA**

Foshjna që u lind,
Nga trupi i Marisë,
Erdhi si yll,
Që i dha dritë gjithësisë.

Nga Gjon Pagëzori,
More emrin tan,
Ti u pagëzove,
Me ujin e Lumit Jordan.

Me ardhjen tane,
Për njerzimin bane ma të mirën,
Ti solle dritën,
Largove errësinën.

Kur Herodit mori vesh,
Se kishte lind mesija,
Urdhëroj që gjithë të vegjëlit,
Të vriteshin nga ushtarët e tija.

Të gjithë të vegjëlit,
Kaluan nan shpatë nga këta mizorë,
Por ti shpëtovë,
Se ishte hyjnor.

Gjatë jetën tanë të shkurtë,
Ti fjalën e Zotit predikove,
Me fjalët e Tij zemrat,
Njërëzve u ndriçove.

Ai të gjithëve na bekoj me dashuni,
E ne jemi bijët e Tij.

Kur për Ty patëm nevojë,
Të verbëtit ja ndrite synin,
Memecit i ktheve gojën,
Shurdhit ndigjimin.

Ti na mësove ti duam,
Njerëzit dhe të vërtetën,
Të japim dashuni,
Të largojmë urrejtjen.

Mos urre vëllanë që ka lind,
Nga ajo nanë që kë lind edhe ti,
Duaje më atë shpirtë e dashuni,
Që të do edhe Jezusi ty.

Duajeni me gjithë dashuni,
Që në shpirtë keni,
Jo me smirë, inate e urrejtje,
Që në shpirtë kishte Kaini.

Këta njerëz të liq,
Që në ligësi e inatë ngelin,

Nga smira, a urrejtja,
Vëllanë e vrasin si Kaini, Abelin.

Në darkën e fundit,
Me apostujt u shtrove,
U the se pa mbaruar darka,
Njëri nga Ju do më tradhëtojë.

Kur dëgjuan këto fjalë,
Të gjithë u tranditën,
Kush asht ai i madhkuar nga Zoti,
Tradhëtari ishte Juda Iskarioti.

Edhe ky kur e kuptoj,
Këtë vepër prej tradhëtari,
U trandit, nuk duroj ma,
Dhe në degën e fikut veten e vari.

Frerizejt vdekjen Tane kërkuan,
Gjithë njerzimi për Ty qau,
Se ishte i pafajmshëm,
Ndërsa Ponc Pilati duart lau.

Njerëzit të gjithë vdesin,
Pra ikun nga kjo jetë,
Por shumë prej tyre,
Vetëm ndrojnë jetë.

Që të shpëtoje botën,
Shumë vuajtje provove,
Deri sa në fund,
Në kryq u gozhdove.

Në zemrën tane, heshta po ngulej,
E shpirti erdhi me dalë,
Sytë nalt i çove, e the,
Fali Zot se s' dinë ça bajnë.

Ti për njerëzimin,
Vuajte edhe në kryq,
Jetën tanë dhë,
Por jetën e riplune për ne.

Ti në kryq ndrove jetë,
Por prap u ringjalle,
E jetën dhe gëzimin
E solle për ne.

Me ringjalljen tane,
Ringjalle jetën,
Gjithë njerëzimit,
I solle shpresën.

Përsëritje Kosove...

Sa herë që unë , tretim në mendime.
.kujtoj historine dhe vendlindjen time.
dhe ndihem me burrë ,ndihem më krenar
"Une jam Dukagjinas , puro Shqipëtar..
Për me ruejt këte emër, me jetu n' liri
dolën t'paret tane atje në malsi....
Për ndonje të "vorfen,, që ala së din..
Gjysma e Kosoves , quhet Dukagjin..
Hasmi na ka nda ,na ka nda kufini..
Vllazën e shqiptar jane gjithë Dukagjini..
Prap ka burra t'vjetër që ala jan gjalle.
në Peje e ne Gjakove kan shku për pazar
Dikush me qeleshe e dikush me plis
me gërmu ndër breza, jena veç një fis
bashke i kena pas stane e livalle. ..
Kur t'sundon i hueji gjithmon je me halle

Edhe Gjergji i mall që ish kapedan
luftoj përkrah Lekes për njezet vatan..
Ismail Qemali që ishte Pasha..
erdhi e'i thirri Isës -- Ku të kam O vlla
Por dikush na shiti, apo na tradhetoj..
Shkjau edhe Serbi na ndau, na sundoj..
kush kërkon lirinë gjithmon i del mire..
Kosova tashme .. do të jete e lire..!
E gëzofsh Kosove , festën e lirise..
Njëra kokë e Shqipës gjysma e Arbërise
Lavdi për deshmoret që rane si martire
që përjetë Kosova të jetoj e lire..
Ah si vyshket festa ,me gjitha kto halle.
ndosha vetëm ëndërr "Shqiperia e malle,,
gjithmon festat tona i prish politika..
Me kë si Europa tani ka ardhe dita..

Plak pa shkolle...!

E pyesin nipat plakun.
-- Pse rënkon gjysh...çfare ke..?..
Më duket do iki shpejt..
..... se paraja jetën nuk e ble..
Pse po ikin gjysh ..?
...krejt bosh është shtëpia ..
--- Po iki jetash më mire ..
... ..se krejt asht prish njerzia ..
Kur djemt se duan këtë vend
.....as unë se dua këtë jete ..!
Punova e vuajta gjithmone..
por asgja marak s'po më mbet ..
Kullën e gurit e lshova..
po vdes në një shpi me qera ..
Tokat e mija i lanë djrrë..
.e kërkush nuk del , as me i pa ..
Tana të mirat po i kam..
por mua s'më pëlqen kurrja ..
Ka humb dashina e besa..
burra ..e shoqni s'ka ma ..
..Të gjithë jetojn me maska...
rrugët me mejhana jan mbush ..
Punën se don asnjëni..
e marrja ka dal për fushë...
Të keqit i thojnë , i fortë..
.. e të mirit i thojnë ..qyqar...!!..
Shumica kan ik nepër bote..
kan turp me than --- Jam shqiptar
Mos ik gjysh ... Mos ik ...
se ndoshta do bëhet më mire ..
-- -- Uroj të bëhet për Ju...
.pormë duket e vështire ...??

Humor erotik...!

Ah moj dashuri ilaç pa dyqan..
që shpirtit njerzor po i ban derman
Para teje mbreti , është kale me kapister
ti e korrupton ma t'mirin minister..
Veç ti fukarane mundesh me e knaq.
ti di me hap sherre , ti di me vu paqe..
Ah moj dashuri ilaç pa recete.
.pa të shiju ty kurrkush s'po ka jete
burrat i ke ba shumicën me zemër..
A thue shejtani paska ken femer..?
Bibel as Kuran kërrkush si lexon
..kur flet dashuria , ligji s' ekziston

Ahh moj dashuri virus pa baktere
Zotnis e tregtarit xhepin ti ja shterre
N'emër t'dashuris shumë po abuzojn.
."mollën e ndaluar,, të gjithë e lakmojn
Kjo moda e re me duket me hile
..pesha ideale 55 kile...?
Ahh moj dashuri o mall pa dogane
ka dal interneti e jan knaq tetane
Çmimin ta kan ul në vlera minimale
aq sa besnikria duket fjal banale
Ndoshta jam plake unë e nuk shoh me sy...?
Ahh moj dashuri , m' vjen gjynah për ty...

Epitaf**Murlani i kohës**

Murlani i kohës që fryn
nga grykat e kapitalit
e vrau buzqeshjën ..

*** Poezi *** Poezi *** Poezi *** Poezi *** Poezi *** Poezi ***

◀ Rrugëve si mjergull
endet pluhuri i urrejtjes
e shpirti njerzor
është mbyllur
në kalane e vetvetes.. ?

Nëse diku ka mbet
një pike burrni...
rruga drejt saj
është pa shteg

Si mall pa vlere..
.... e pa treg.....?

Murlani i kapitalit
e ka ftoh njerine...
e ka vrare drejtesine
askush se pranon

.. por të gjithë e dine..!
Mbi varrin e shpirtit njerzor
derdha pak lot

ndjeva shume nostalgji

Pastaj ...
shkrova disa vargje
që mu duken si poezi.?

..... Për ngut..?

Kur jam për ngut.

kur jam me nerva

dhe pa qetsi....

krejt botën

e ndaj në dy pjesë

të mire

dhe të keqinj...

Në njërën krah janë shumë

në krahun tjetër

veç pak sa për be.

por ska gja....?

Ne ju themi të keqinj

..e njashtu na thojne

edhe ata ne..?

Fundja

ata jane shumica .

.dhe kane të drejt gjithmon ..

fajtori jam unë

që nuk e vras mendjen .

.çka bëjnë

as çfarë thonë...?..

Shumë ma keq jam me ty .

. po ashtu

edhe ti me mua.....?

Zihemi ...

e pajtohem njëmije herë

por prap

..e kupton se të dua .

Grua e dhunuar

Për ty viti s'ka pranverë....

.....për ty dimr është gjithherë ..

Për ty lulet veç lotojnë

..... për ty zogjte kot cicërojë

Ti e shkove kot rininë.

.pa e prek kurrë dashurine..

Më mire qyqe në vetmi ..

...se me burrin , kafshënjeri ..!!

Për ty jeta është një ferr...

.....nata vdekje e dita sterr..

As buzëqeshje as gëzim..

..... jeta gati pa kuptim

Për ty buka është me gjak...

....punë pafund e fjal aspak..

Për ty burri është vetë djalli ..

.....aaaah bre jetë ...Jetë halli ...?!

Për ty grua e dhunuar....

Zoti kurrë s'ka ekzistuar !!

Se nuk ka më poshtërsi ..
.....të gjakosish gra e fmi
Shtëpia burg.. e qielli ëndërr.
....mallkon veten që je femër ..
Sepse burri ..që është burre ..
....me një grua nuk matet kurrë..
Ahh kjo botë ..botë e padrejte .
.....duket fundin e ka të shpejte..
Nuk ka më ligj , as moral...
askush s'din të thote ..Me fal
A thu njerzimin e çmendit e mira..?
.....disa, jan bëre si egersira ..
Dhunë , krime..dhe padrejtsi..
.Ku po shkojm valle..? . Se di..!!



SHTEGTOJNË DALLËNDYSHET

Na mbyten djajtë me dashje
Poemë

Homazh viktimave të tragjedisë së Otrantos me 28 Mars 1997,
ku mizorisht humbën jetën 81 njerëz, kryesisht gra dhe fëmijë

Çerdhja e juej si kube
Me "beton"e ngjitur fort
E ke ba me pështymë e dhe
As termeti nuk e lot.

Vogëlushët xhan të kanë
Hapën gojën kur të panë
Ti ju solle për të ngranë
Kokrra gruri nga këto anë.

Nuk e di zog i shtrenjtë
Që afër meje fluturon
A do mundësh me e gjetë
Shqiptarët kush i dëbon?

Fatkeqit i vdiq grueja
Duke u kapur për litar
Në mes valëve "iku"e shuemja
Atje ndodhet varri i saj.

Në thellësitë e territ të natës
Qindra njerëz hypen në vapor
Vajza e vogël kërkon nanën
I fshinë lotët me shami në dorë.

Britma fëmijësh, oh sa siklet!
Nga tmerrit s'kanë gjumë
Në mes tyre një grue thërret:
"Burri im mori fund"!

Tyyy...tyyy... ushton vaporit
Është ba gati me u nisë
Na"pushtoi" kudo mizori!

Vendin tonë me e braktisë!

*Jam dallëndyshja ciu, ciu
Ah, zemra ime e shkretë!
Shumë të këqija i vijnë njeriut
Nga lubitë në tokë e në det!*

*Medet, ç'është kjo përplasje?!
Po na futet uji mbrenda!
Na mbyten djajtë me dashje!
O Zot, ç'don tek ne vdekja?!*

Mizoria nuk ka limit!
Tmerr i madh kudo në sallë!
Dikush lutet me gjithë shpirt!
Kurse tjetri shpërthen në vaj!

LULASH BRIGJA

Disa herë e mjera nanë
Dallëndyshet fluturuen mbi det
Ato krahët i përplasen në valë
U ban gati për me "vdekë"!

Nana babe- erdhi dallëndyshja
Ajo qënka shumë e bukur!
Po bir-përgjigjet gjyshja
Asht si lule dhe si flutur!

Gjyshe u ban dy dallëndyshe
Duan me ardhë në shtëpi
Kërkojnë një jetë ndryshe
A ti lejoj mbrenda me hy?

Shiko nanë si fluturojnë
Janë krenare me dinjitet
Ato jetën e fitojnë
Me djersë të ballit ditë e netë.

*Do të çojë me bagëtitë
Atje lartë në shpat të malit
Të ushqesh e të mjelësh dhitë
Në qytet të sjellësh tamblin.*

*Kurse ti të shkosh në arë
Çdo punë duhet të bësh
Të jesh kurdoherë i parë
Asgjë mangut mos të lësh.*

*Të prashitësh e të ujitësh
Këtu tek ne nuk ka orar
Të vjelësh e të kositësh
Dhe pastaj të bësh mullar.*

Menjëherë u çuen dallëndyshet
Rreth e rrotull u shpërndanë
U tmerruen moj nana babe!
E s'po dijnë në breg me dalë!

Është nata e mergimit
Sherbëtorë në dyer të botës!
Dhe "Poema e Mjerimit"
Në "kerthizë" të Evropës.

Ç'është kjo fotografi?
Nuk mund ta shikoj!
Në dhe të zi Ti me hi?!
E shkreta, kush të denoj?!

*"Dallëndyshe" të paska vra
Pjella e ndyrë e "Qytetërimit"!
Çdo shqiptar duhet me të kja
Me shpatë në dorë kundër kimit.*

Luigj Temali., Shkodër 14 Mars 2016

REDAKSIA

Kryeredaktor: Luigj Shyti

Redaktorë: Lazër Stani, Roza Pjetri, Prelë Milani, Lazër Kodra,
Suela Ndoja, Zef Nika, Zef Gjeta, Lulash Brigja

Mundësoi Botimin: AV. TONIN MARKU

Anëtar i Shoqatës Atdhetare Dukagjini,
Shkodër

